

URDHËR
Nr. 157, datë 10.3.2020

PËR MARRJEN E MASAVE PËR PARANDALIMIN E INFEKTIMIT NGA COVID-19
TË PËRFITUESVE TË SHËRBIMEVE TË PËRKUJDESIT SHOQËROR

Mbështetur në nenin 116, pika 3, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, si dhe në ligjin nr. 10107, datë 30.3.2009, “Për kujdesin shëndetësor në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, të nenit 7, të ligjit nr. 57/2019, “Për parandalimin dhe luftimin e infeksioneve dhe sëmundjeve infektive”, të vendimit të datës 8.3.2020 të Komitetit të Përkohshëm për infeksionin e përhapur nga Coronavirusi i ri, si edhe të udhëzimit të Institutit të Shëndetit Publik, me qëllim mbrojtjen e popullatës nga infeksioni i shkaktuar nga COVID-19,

URDHËROJ:

1. Në institucionet e përkujdesit shoqëror pezullohen/ndalohen vizitat nga të afërm dhe familjarë. Në raste specifike vizitat mund të lejohen vetëm me miratimin e titullarit të Shërbimit Social Shtetëror.

2. Institucionet e përkujdesit shoqëror të marrin masa të shtuara higjieno-sanitare, deri në dezinfektimin e ambientit nëse kjo do të rekomandohet nga strukturat përgjegjëse.

3. Të gjitha njësitë vendore të kujdesit shëndetësor të vendosin kontakte me drejtuesit/mjekët që ushtrojnë veprimtari pranë institucioneve të përkujdesit shoqëror, rezidencial dhe ditor, publik dhe jopublik dhe të monitorojnë situatën shëndetësore të përfituesve që marrin shërbim pranë këtyre institucioneve dhe personelit të institucionit.

4. Mjekët që ushtrojnë veprimtari pranë institucioneve të përkujdesit shoqëror, rezidencial dhe ditor, publik dhe jopublik, të raportojnë në njësitë vendore të kujdesit shëndetësor dhe pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Shërbimit Social Shtetëror mbi monitorimin e procesit në këto institucione.

5. Mjekët që ushtrojnë veprimtari pranë institucioneve të përkujdesit shoqëror rezidencial dhe ditor, publik dhe jopublik, për çdo rast të dyshuar ndjekin protokollin e miratuar nga Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale dhe Instituti i Shëndetit Publik.

6. Ngarkohen për zbatimin e këtij urdhri Operatori i Shërbimeve të Kujdesit Shëndetësor, Shërbimi Social Shtetëror, Inspektorati Shtetëror Shëndetësor, të cilët duhet të bashkërendojnë punën me njësitë e vetëqeverisjes vendore.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë.

MINISTËR I SHËNDETËSISË
DHE MBROJTJES SOCIALE
Ogerta Manastirliu